

VENDIM
Nr.23, datë 20.1.2010

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE BËRTHAMORE

(Ndryshuar me VKM nr. 279, datë 7.4.2010; nr. 637, datë 19.9.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare Bërthamore (më poshtë AKOB), si institucion qendror në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me statusin e personit juridik publik, me seli në Tiranë që e zhvillon veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë. AKOB-i ka vulën dhe stemën e vet zyrtare.

2. AKOB-i ka objekt të veprimtarisë përgatitjen, ndjekjen e mbarrëvajtjes dhe të zhvillimit të programit kombëtar bërthamor, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit.

3. Detyrat dhe objektivat e AKOB-it janë:

- Ngritja dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës së nevojshme, në mbështetje të programit kombëtar bërthamor.

- Hartimi i kuadrit të plotë ligjor, i cili do të mbështesë zhvillimin normal të programit.

- Hartimi i kuadrit të nevojshëm rregullator, në shërbim të programit.

- Bashkërendimi i punës për përzgjedhjen e vendeve, në të cilat mund të ndërtohet centrali bërthamor.

- Përzgjedhja dhe sigurimi i përgatitjes profesionale të personelit të nevojshëm, në mbështetje të programit bërthamor, në faza të ndryshme të tij.

- Hartimi i dokumentacionit dhe ndjekja e procedurave, në bazë të të cilave do të kërkohej oferta për centralin bërthamor.

- Ndjekja, gjatë të gjitha fazave, e procedurave dhe ecurisë për ndërtimin dhe vënien në funksionim të centralit bërthamor.

- Sigurimi i ruajtjes, afatshkurtër dhe afatgjatë, së lëndës djegëse bërthamore, si dhe të materialeve radioaktive, të cilat lidhen me procesin e prodhimit të energjisë nga centrali bërthamor.

- Njohja e popullatës dhe e grupeve të interesit me programin bërthamor, gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të tij.

- Vlerësimi i zhvillimit, sipas planifikimit dhe parashikimit të fazave të ndryshme të programit bërthamor.

- inspekton dhe verifikon gjendjen dhe inventarin e raportuar nga përdoruesit dhe zotëruesit e lëndëve e të materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive;

- harton raportet për materialet e sipërpërmendura dhe përdorimin paqësor të energjisë dhe teknologjisë bërthamore;

- informon në vazhdimësi Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA) për gjithçka dhe sa herë është parashikuar në protokollin shtesë të marrëveshjes së garancive.

4. AKOB-ja, për të realizuar misionin dhe objektivat e saj, si dhe për plotësimin e detyrimeve institucionale, që rrjedhin nga protokollin shtesë i marrëveshjes së garancive, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë ndërmjet institucioneve të ndryshme të vendit, publike dhe/ose private, të grupeve të interesit, vendase dhe/ose të huaja, dhe, konkretisht, me:

- Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar;
- Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi;
- Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA);
- struktura të ngjashme të vendeve të ndryshme të rajonit dhe të botës;
- universitete dhe institucione kërkimore në fushat që mbulon dhe përfshin programi kombëtar bërthamor;

- institucione jofitimprurëse e donatorë të ndryshëm vendas dhe/ose të huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

- institucionet, publike e private, përdoruese dhe zotëruese të lëndëve e materialeve, të parashikuara në protokollin shtesë dhe në vetë marrëveshjen e garancive.

5. AKOB-i është institucion buxhetor dhe financohet nga:

- Buxheti i Shtetit;
- burime financiare nga palë të treta, të destinuara për programin kombëtar bërthamor, nga fonde të institucioneve ndërkombëtare, të shteteve të veçanta dhe të organizatave të ndryshme, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- donacione të subjekteve fizike dhe/ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe/ose i huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

6. Organet drejtuese të AKOB-it janë:

- Këshilli drejtues,
- Kryetari.

7. Përbërja e këshillit drejtues përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Funksionimi dhe detyrat e këtij këshilli përcaktohen në statutin e AKOB-it. Statuti dhe rregullorja e funksionimit propozohen nga kryetari i AKOB-it dhe miratohen nga këshilli drejtues. Këshilli drejtues miraton buxhetin, planin e përgjithshëm të veprimtarive, si dhe dokumentet strategjike të AKOB-it.

8. Kryetari është titullari i institucionit dhe përfaqëson AKOB-in në marrëdhënie me të tretët. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra e kryetarit të AKOB-it bëhen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

9. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare Bërthamore miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

10. AKOB-i i raporton një herë në vit Kryeministrit e, në mënyrë periodike, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për ecurinë dhe zhvillimin e programit bërthamor në vend.

11. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKOB-it rregullohen me Kodin e Punës. Procedurat e emërimit dhe të lirimimit nga detyra të punonjësve të AKOB-it bëhen në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe me aktet nënligjore në fuqi. Niveli i pagave të punonjësve të AKOB-it përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave të marrë masat e nevojshme për sigurimin e mjediseve të punës për punonjësit e AKOB-it.

13. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

14. Paragrafi i fundit i pikës 3 të vendimit nr.547, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI